

PARTNERËT



Maratonë

vullnetare



PËRFSHIRJE RINORE

Financuar nga:



Një projekt i Agjencisë Zvicerane SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

Manual

“Aktivizëm Rinor”

Angazhimet vullnetare – Nisma të cilat
ndërmerren çdo ditë e më shumë

Ky publikim është prodhuar në kuadër të projektit “YOUth ACTING” i cili realizohet me mbështetjen financiare të LevizAlbania dhe është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, SDC Mendimet dhe opinionet e shprehura në të i përkasin autorëve realizues dhe nuk përkojnë domosdoshmërisht me qëndrimet e donatorit

Tiranë, 2022



Përmbajtja

1. Parathënie	5
2. Partneriteti	6
3. Koncepti i vullnetarizmit dhe vlerat e tij	7
3.1 Vullnetarizmi	8
3.2 Arsytet për t'u angazhuar në vullnetarizëm	9
3.3 Rëndësia e vullnetarizmit	10
4. Aktivizëm Rinor	12
4.1 Zhvillimi i Kulturës së Angazhimit Vullnetar	13
4.2 Rrjetëzimi Rinor Vullnetar	15
5. Qëndrueshmëria dhe Vijimësia	25
5.1 Përgjegjësitë dhe Roli i Vullnetarit	27
5.2 Përgjegjësitë dhe Roli i Institucioneve	28
5.3 Shkalla e Pjesëmarrjes në Vullnetarizëm	29
6. Mbështesni YOUTH ACTING	31
7. Referenca	36



PSE KY MANUAL?

Ky manual, i drejtohet qeverisjes vendore dhe institucioneve të tjera edukative që veprojnë në vend me qëllim nxitjen e vullnetarizmit tek të rinjtë dhe zbatimin e modeleve të angazhimit vullnetar të praktikuara edhe në vende të tjera.

Ka një angazhim të shtuar në përpjekjet që ndërmerren për rritjen e pjesëmarrësve të rinj në aktivitete vullnetare, por edhe monitorim dhe institucionalizim të vullnetarizmit. Pavarësisht se vullnetarizmi konsiderohet si një mjet për rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në sferën sociale, ai gjithashtu është dhe një koncept dinamik i cili ka në thelb fuqizimin dhe përfshirjen sociale rinore, zhvillimin potencial të kapacitetit të tyre dhe aftësimin e tyre për ti sjellë të rinjtë sa më pranë nevojave të tregut të punës. Vetëm duke pasur eksperiencën vullnetarizmi një i/e ri/e do të ndihet më i/e sigurt në karrierën e tij profesionale.

Nëpërmjet këtij projekti, i cili kishte si qëllim ndërgjegjësimin rinor marrjen e një roli aktiv në komunitet e angazhime solidariteti, u synua edhe institucionalizimi i vullnetarizmit me perspektivën e funksionimit si aktivitete jofomale në të ardhmen duke siguruar edhe mbështetje nga organizatat e shoqërisë civile si dhe bashkëpunëtorë të tjerë.

Partneriteti

Projekti u zbatua nga një partneritet i konsoliduar e me eksperiencë në zbatime të projekteve sociale si vijon:



QENDRA YOUTH ACT - është një organizatë jofitimprurëse, me seli në Tiranë – Shqipëri, e themeluar dhe e regjistruar ligjërisht në korrik 2013, në të cilën synon të fuqizojë të rinjtë për të marrë një rol aktiv në jetën e tyre, familjen. dhe shoqërinë. Qendra udhëhiqet nga të rinjtë për të rinjtë. Youth Act ofron një qendër për të mbështetur individë, organizata dhe iniciativa që fokusohen në punësimin e të rinjve në Shqipëri. Youth Act udhëhiqet nga kreativiteti, prosperiteti, sipërmarrja dhe integriteti dhe fokusohet në shtatë fusha kryesore: Kulturë, Art dhe Sport; Qytetari dhe Demokracia; Arsimi dhe trajnimi; Karriera dhe Punësimi; Globalizimi; Inovacioni, Mjedisi dhe Multimedia.



QENDRA INFORMATIVE AARHUS - është një organizatë jofitimprurëse, me seli në Shkodër e themeluar më 05.03.2009 e cila synon të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe mjedisin e shëndetshëm nëpërmjet promovimit të zbatimit të Konventës së Aarhusit nga pushteti vendor në Shqipërinë e Veriut. Në këtë kuadër, qendra ofron shërbime dhe konsulencë të ndryshme në çështjet mjedisore për palët e interesuara si institucionet publike, OJQ-të, komunitetin, biznesin, etj.) me fokus në ndërgjegjësimin e qytetarëve nëpërmjet përfshirjes së drejtpërdrejtë në proceset vendimmarrëse që lidhen me mjedisin dhe mbrojtjen e shëndetit.



Qendra e Këshillimit të Grave dhe Shërbimeve Sociale
KUKËS

QENDRA E KËSHILLIMIT TË GRAVE DHE SHËRBIMEVE SOCIALE KUKËS - është një organizatë jofitimprurëse, me seli në Kukës themeluar më 05.02.2007 e cila synon të promovojë programe dhe shërbime komunitare në mbështetje të grupeve vulnerabël, veçanërisht vajzave dhe grave, të rrisë ndërgjegjësimin për dhunën në familje dhe të drejtat e grave në veri të Shqipërisë. Kjo organizatë ka eksperiencë të gjerë në zbatimin e projekteve me në fokus të drejtat e njeriut dhe kryesisht gratë e vajzat, projekte të financuara nga donatorë të ndryshëm vendas e të huaj. Misioni i saj është promovimi i barazisë gjinore, mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe shërbime me qëllim përmirësim jetën në komunitet.

KONCEPTI I VULLNETARIZMIT DHE VLERAT E TIJ



Vullnetarizmi

Shpeshherë ne nënvlerësojmë rëndësinë e një fjale të ngrohtë, të një veprimi përkujdesës, të dëgjimit të dikujt tjetër, të cilat kanë një fuqi të jashtëzakonshme për të ndryshuar gjithçka.

Leo Buscaglia

Vullnetarizmi si koncept është baza e marrëdhënieve njerëzore pasi lidhet ngushtësisht me nevojën që kanë njerëzit për të marrë pjesë në shoqëritë e tyre dhe për të ndërë se kanë rëndësi për të tjerët. Madje, edhe marrëdhëniet shoqërore që vijnë si rezultat i angazhimit vullnetar kanë rëndësi në mirëqenën si në nivel individual, ashtu edhe komunitar. Vullnetarizmi nxjerr në pah aspiratat më fisnike të njerëzimit siç janë paqja, toleranca, liria, krijimi i mundësive të barabarta, parimet e së drejtës etj.

Aktivitetet vullnetare – qoftë përmes veprimeve individuale apo kolektive – janë mënyra në të cilat:

- vlerat njerëzore të komunitetit, kujdesit dhe shërbimit mund të jenë të qëndrueshme dhe të forcuara;
- individët mund të ushtrojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre si anëtarë të komuniteteve, ndërsa mësojnë dhe rriten gjatë gjithë jetës së tyre, duke realizuar potencialin e tyre të plotë njerëzor;
- lidhjet mund të bëhen ndërmjet dallimeve që na edukojnë që të mund të jetojmë së bashku në mënyrë të shëndetshme dhe të qëndrueshme në komunitetet, duke punuar së bashku për të ofruar zgjidhje inovative për sfidat tona të përbashkëta dhe për të formësuar ndjenjat e kolektivitetit e të përfshirjes sociale.

Vullnetarizmi është një aktivitet individual që ndërmerret për të mirën e komunitetit. Ky aktivitet nuk motivohet financiarisht, por realizohet me vullnet të lirë, si motivim personal. Vullnetarizmi është një aktivitet paqësor dhe tolerant me respekt të zhvilluar ndaj të tjerëve, aktivitet që inkurajon zhvillimin e potencialeve njerëzore, rolin e qytetarit aktiv dhe përmirëson cilësinë e jetesës duke zgjidhur probleme konkrete.

Vullnetarët janë individë që arrijnë përtej kufijve të punësimit të tyre me pagesë dhe të përgjegjësi të tyre normale për të kontribuar kohë dhe shërbim për një kauzë jofitimprurëse, me besim të plotë se aktiviteti i tyre është i dobishëm për të tjerët, si dhe i kënaqshëm për veten e tyre.

Në botë, mbi 1 bilion persona kryejnë shërbim vullnetar.

Arsyet për t'u angazhuar në vullnetarizëm

Angazhimi vullnetar kërkon që të rinjtë, grupe të tjera të komunitetit e institucione të ndryshme të kenë mundësinë, hapësirat dhe mbështetjen e nevojshme për të dhënë kontributin e tyre në komunitet e për të ndikuar në zhvillimin social e të mirëqenies së komunitetit në tërësi.

- Është e shëndetshme.
- Ju ndihmon në zgjedhjen e karrierës.
- Përfitoni aftësi të reja.
- Eksploroni botën e vërtetë.
- Bëheni shembull për komunitetin.
- Fokusoheni në çështje në të cilat ju besoni.
- Ndihamoni të tjerët të fuqizohen.
- Bëheni më të përgjegjshëm.
- Krijoni lidhje reale.
- Mësoni gjuhë të reja.
- Bëheni pjesë e një komuniteti.
- Zbuloni perspektiva të reja.
- Eksploroni më shumë.
- Frymëzoheni.
- Merrni shumë gëzim.

Çdo person mund të sjellë një ndryshim dhe çdo person duhet të përpiqet.
John Kennedy

Gati 75% e amerikanëve mendojnë se vullnetarizmi do të marrë më shumë rëndësi pas pandemisë Covid-19

Rëndësia e Vullnetarizmit

“Pyetja më e vazhdueshme dhe urgjente e jetës është, çfarë po bëni ju për të tjerët?”

Martin Luther King, JR

SISTEMI I VLERAVE - Duke marrë pjesë në aktivitete vullnetare, vullnetarët fitojnë mundësi të ndërtojnë një sistem pozitiv vlerash njerëzore. Nga njëra anë, tek vullnetarët forcohet ndjenja e përgjegjësisë për komunitetin dhe nga ana tjetër ndërtohen vlerat e një shoqërie civile si: toleranca, solidariteti, bashkëjetesa kulturore e fetare, barazia gjinore, mohimi i dhunës, mbrojtja e mjedisit, zhvillimi individual e social dhe vlerat pro sociale në tërësi.

Vullnetarizmi jep mundësinë për të zhvilluar respektin për veten, për individin dhe mundësinë e vetëaktualizimit. Është vërtetuar se njerëzit e vetë-aktualizuar zotërojnë cilësinë e pranimit të plotë të vetvetes dhe të tjerëve ashtu siç janë ata janë, ata kanë një ndjenjë përlulesie dhe respekti ndaj të tjerëve, respektojnë vlerat demokratike, janë të hapur ndaj etnisë dhe shumëllojshmërisë individuale dhe madje e vlerësojnë atë. Njerëzit e vetëaktualizuar gëzojnë marrëdhënie më të thella e më të sinqerta me njerëzit. Ata mendojnë se qëllimet nuk justifikojnë domosdoshmërisht mjetet, dhe me pjesëmarrjen në një aktivitet të caktuar arrijnë qëllimet dhe përmirësojnë veten dhe mjedisin e tyre.



Të rinjtë angazhohen në mënyra dhe rrugë nga më të ndryshmet. Si eksperte e çështjeve rinore theksoj angazhim aktiv të të rinjve në:

- Qeverinë e Nxënësve në shkollë;
- Parlamentet Rinore;
- Parlamentin e Nxënësve të Shqipërisë;
- Këshillat Studentore dhe Klubet Studentore në Universitet;
- Këshillat Vendor Rinor pranë Bashkisë në qytetin ku jeton,
- Mbledhjet e Këshillit Bashkiak; Kuvend, sipas programeve që Institucioni ofron;
- Organizatat e Shoqërisë Civile.

Erviola Osmanaj – Eksperte e Çështjeve Rinore

Rëndësia e Vullnetarizmit

Vullnetarizmi kontribuon në zhvillimin e karrierës profesionale dhe pozicionim më të mirë në tregun e punës.

MUNDËSITË PËR PUNËSIM - Të mësuarit joformal në aktivitetet vullnetare bazohet në të mësuarit individual. Aktivitetet e të mësuarit joformal i ndihmojnë të rinjtë të jenë të aftë të përshtaten me ndryshimet dhe situatat. Të mësuarit joformal ofron hapësirë dhe mundësi për të rinjtë për të provuar gjërat, për të bërë gabime dhe për të mësuar prej tyre. Në këtë mënyrë, ata mund të fitojnë vetëbesim bazuar në njohjen e kapaciteteve të veta dhe mënyrave se si mund t'i përdorin ato. Falë të mësuarit joformal, të rinjtë formojnë dhe zhvillojnë kompetencat e tyre si dhe sfidojnë veten në mënyrë të vazhdueshme.



*Të qenit pjesë e vullnetarizmit është një dëshirë që të bën të ndihesh i përfshirë në komunitet. Të bën të ndihesh i përfshirë në "Veprime të mira", pra në akte të vogla humane që nuk bëjnë asgjë më shumë veçse ngrejnë lartë shpirtin e njeriut. Na mëson sesa e vlefshme është jetesa në bashkësi.
- Pjesëmarrës në projekt*

Aktivizimet vullnetare tek të rinjtë rrisin ndjeshëm "aftësitë e buta" si:

- Zhvillimi i komunikimi të sigurt dhe efektiv me kompetenca të dëgjimit aktiv dhe reagimit konstruktiv, si dhe zhvillimi i kompetencave për të folur në prezantime publike;
- Menaxhimi i konflikteve dhe zgjidhja me kompetencë për t'u përballur me situata të vështira apo edhe të qenit nën presion;
- Zhvillimi i kompetencës ndërkulturore dhe gjithëpërfshirëse të pranimit të tjerëve ashtu siç janë dhe i aftësive për të punuar dhe mësuar prej tyre;
- Zhvillimi i inteligjencës emocionale me kompetenca për të zhvilluar marrëdhënie cilësore ndërpersonale;
- Zhvillimi i aftësive të punës në grup, krijimit të ekipit dhe rrjetëzimit në nivel ndërpersonal dhe organizativ, me kompetenca të bashkëpunimit, negocimit, mentorimit etj.
- Udhëheqja dhe menaxhimi i njerëzve dhe aktiviteteve të tjera, duke përfshirë menaxhimin e kohës; aftësitë e planifikimit dhe organizimit; vendimmarrjen; zgjidhjen e problemeve; aftësinë për të ndjekur udhëzimet/rregullat; aftësinë për të investuar dhe për të ndarë energji të mirë, entuziazëm, frymëzim dhe motivim;
- Zhvillimi i aftësive lidhur me të menduarit sipërmarrës me aftësi për të vepruar siç duhet, analiza e nevojave dhe hulumtimi i komunitetit, ndërmarrja e nismave dhe e zgjidhjeve inovative në fushën e sipërmarrjes sociale dhe të biznesit;
- Zhvillimi i të menduarit kritik dhe i aftësinë për të vendosur objektivat e duhura dhe për të ndjekur arritjen e tyre nëpërmjet metodave të ndryshme; me kompetencë edhe për vetëreflektim, vetëmonitorim etj.

AKTIVIZËM RINOR

Aktivitetet Vullnetare si Proces të Përfitimit të Ndërsjelltë



Zhvillimi i Kulturës së Angazhimit Vullnetar

*Mënyra më e mirë për të gjetur vetveten është të humbësh në shërbimet
për të tjerët.
Mahatma Gandhi*

Përfshirja rinore lidhet me 2 elementë kryesorë: ZËRI dhe VEPRIMI

ZËRI – Të rinjtë shprehin mendimet e tyre tek përfaqësuesit e vendimmarrësve (politikanë, mësues, lidera etj.) me qëllim që këta persona të bëjnë ndryshime nisur nga vetë idetë e të rinjve.

VEPRIMI – Të rinjtë ndermarrin nisma individuale apo kolektive për të bërë një ndryshim në komunitetin ku bëjnë pjesë.

Angazhimi rinor në aktivitete vullnetare patjetër që shoqërohet me rezultate pozitive në komunitet. Nga ana tjetër, angazhimi vullnetar zhvillon disa sjellje e qëndrime si shprehja e mendimit, negocimi, zgjidhja e konflikteve, të menduarit kritik, analiza e informacionit, argumentimi i një ideje apo këndvështrimi personal, zhvillimi i respektit e i tolerancës, dhe një ndjenjë gatishmërie për të dëgjuar e për të dalë në mbrojtje apo në ndihmë të të tjerëve.

Të rinjtë angazhohen nëse:

- Ata ndjehen të vlerësuar, të besuar, të motivuar dhe të sigurtë.
- Ata përfshihen të punojnë në mjedise miqësore dhe që u japin atyre vlerë.
- Ata mund të shprehin lirshëm dhe të shprehin idetë e argumentet e tyre;
- Atyre u jepet mundësia të përfshihen e të marrin vendime, të përfitojnë aftësi lidhësi dhe të shohin idetë e tyre të realizuara;
- Të ndjejnë respektin shoqëror që buron nga përfshirja e tyre;
- Të shohin arritjet apo ndryshimet që sjell përfshirja e tyre;
- Të bashkëveprojnë në një mjedis ku kanë të drejta dhe përgjegjësi;


Te gjithëve ne na ka ndodhur të ndihmojme dikë në perditshmerinë tonë qoftë dhe pa e vënë re dhe kjo është çfarë e bën këtë akt të veçantë, ti nuk pret një përfitim apo kërkon dicka në këmbin, ti e bën pa e menduar dhe se vërtet ke dëshirën për të bërë mirë.

Pjesëmarrës në projekt

“Cilësia e jetës tënde përcaktohet nga cilësia e kontributit që jep. Kur ti punon për të ndihmuar jetët e të tjerëve, jeta jote përmirësohet automatikisht.”

Kurek Ashley

PARIMET	SHPJEGIMI
Qëllimi	Një grup interesi ndërtohet e funksionon pikërisht sepse anëtarët e tij ndajnë të njëjtin qëllim dhe e përbushin atë me devotshmëri.
Identiteti	Anëtarët zgjerojnë shoqërinë e tyre e ndërtojnë marrëdhënie të ndërsjella.
Reputacioni	Anëtarët ndërtojnë një reputacion të mirë bazuar edhe në mendimet dhe sjelljet e të tjerëve.
Vendimmarrja	Anëtarët e Klubit të Vullnetarëve ndajnë role e detyra duke lejuar gjithësecilin të rritet e të zhvillohet.
Komunikimi	Vullnetarët ndërveprojnë me njëri-tjetrin sipas pjekurisë, rolit që kanë, eksperiencës e përkatësive personale duke zhvilluar ndjenjë mirëkuptimi.
Mjedisi	Një ambient i këndshëm e miqësor, ndihmon vullnetarët të arrijnë qëllimet e tyre e të japin energji për komunitetin përreth.
Kufizimet	Ndjenjat e tolerancës e të mirëkuptimit ndihmojnë vullnetarët të kuptojnë liritë e përgjegjësitë e gjithësecilit.
Ndërveprimi	Shkëmbimi i vlerave, dijeve, dhe eksperiencës ndihmon vullnetarët dhe komunitetin në tërësi të njohë e të përshταςë të tilla forma të sjelljes shoqërore.
Imazhi	Vullnetarët kanë personalitet dhe angazhimi në nisma të tilla i ndërgjegjëson ata për veten dhe për të tjerët.
Qëndrueshmëria	Vullnetarët duhet të mbajnë të dhëna për çfarë kanë bërë dhe duhet të aktivizohen për të tjera nisma.



Rrjetëzimi Rinor Vullnetar

Ngritja e Klubit të Vullnetarëve, zhvillimi dhe transformimi i tij si dhe qëndrueshmëria e produktiviteti, ndërlidhen në një proces dinamik e aspak të qëndrueshëm i cili kalon në disa hapa kryesore:

1. Formimi i Partneritetit;
2. Parimi i Gjithëpërfshirjes dhe i Diversitetit;
3. Aktivizim Rinor që në Idejim të Nismës;
4. Zgjerim i Rrjetëzimit Rinor në Vullnetarizëm;
5. Mjedisi Rinor Miqësor;
6. Zhvillimi i Kontakteve të Qëndrueshme;
7. Transmetimi i Njohurive dhe Prezantimi i Modelit;

Hapni dyert!

Të rinjtë me të ardhura të ulëta përfitojnë shumë nga vullnetarizmi. Mbi të gjitha, sigurohuni që mundësitë që ofron institucioni juaj të jenë të aksesueshme nga të gjitha popullatat. Kini parasysh se disa të rinj mund të kenë nevojë për transport apo akses në internet për t'u regjistruar në këto mundësi. Konsideroni të punoni me shkollat në komunitetin tuaj për të zhvilluar programe të bazuara në shkolla, si një mënyrë mirësearchje për nxënësit.

*Me kalimin e viteve ju kuptoni se keni 2 duar – një për të ndihmuar veten dhe tjetrën për të ndihmuar të tjerët.
- Audrey Hepburn*

Formimi i Partneritetit

Komunitetet formësohen nga grupe të ndryshme, struktura komplekse, e institucione të cilat në mënyrë paralele apo të ndërvuar krijojnë gjithë strukturën e funksionimit e të zhvillimit të ketij komuniteti. Përsa i përket krijimit të një mjedisi që siguron zhvillim të qëndrueshëm të konceptit të vullnetarizmit, janë shumë grupe interesi të cilët përfshihen e ndërthuren duke krijuar një mjedis dinamik. Kultura e përfshirjes në aktivitete vullnetare po zhvillohet gjithmonë e më shumë e si rrjedhojë shfaqen problematika në angazhimin e institucioneve përgjegjëse në rritjen e numrit të të rinjve në vullnetarizëm e në angazhimin e tyre në aktivitete vullnetare.

Partneritetet me organizatat e shoqërisë civile, qendrat rinore, shkollat, grupet e tjera rinore që veprojnë në komunitetin tuaj, janë mënyra efektive dhe të dobishme në lehtësimin e procesit të angazhimit rinor në vullnetarizëm. Partneriteti sjell diversitet dhe siguron një mënyrë shumë të mirë për të mësuar gjëra të reja. Në këtë mënyrë, ju do të siguroni vazhdimisht të rinj të angazhuar të cilët do të afrojnë përsëri të tjerë në nismat e ndërmarra. Nga ana tjetër do të forconi lidhjet i ri-i rritur që në fazat e planifikimit.

Aktivizem Vullnetar



Organizata të shoqërisë civile;
Qytetarët,
Grupet rinore;
Media;
Qendrat e rekreacionit;
Biznesi;
Shërbimet sociale;
Shkollat;
Prindërit/Familjet;
Borde të ndryshme;

Ndërtimi i komuniteteve të sigurt

Adoleshentët që përfshihen në aktivitete vullnetare kanë 50% më pak mundësi të përfshihen në sjellje të rrezikshme, si dhe më shumë mundësi të përjetojnë mirëqenie psikologjike. Sipas Indeksit të Mundësive 2017, komunitetet e shkëlqyera sigurojnë një infrastrukturë që mbështet pjesëmarrjen qytetare (si vullnetarizmi dhe votimi), shëndetin, edukimin dhe punën. Duke siguruar mundësi vullnetare për të rinjtë, organizatat mund të punojnë për fuqizimin e besimit dhe ndërtimin e një ndjenje uniteti ndërmjet anëtarëve të ndryshëm të komunitetit.

Kur diversiteti është prioritet, të gjithë përfitojnë. Në shumë raste përforcohet fakti se angazhimi pa dallime etnike, racore, gjeografike, sociale e ekonomike duhet respektuar e madje duhen përqafuar për të promovuar tolerancën e luftuar diskriminimin.

Njihuni thellësisht me kulturën, besimin dhe vlerat e të rinjve. Si mund të nxitet interesi i të rinjve për përfshirje në aktivitete vullnetare?

Komunikoni me qeveritë studentore, këshillat rinor, qendrat rinore e të merrni këshilla se si mund të lidheni me të rinj të tjerë të cilët nuk aktivizohen në mënyrë sistematike.

Siguroni të rinjtë që mundësitë për përfshirje janë të prekshme e të aksesueshme nga të gjithë. Konsultohuni me ta dhe diskutoni se cilat mund të jenë kohët e përshtatshme për takime periodike.

Jepni një informacion të saktë tek të rinjtë që pjesëmarrja në aktivitete vullnetare e në përfshirje rinore nuk është e detyrueshme. A ka informacion të mjaftueshëm për të rinjtë lidhur me pritshmëritë dhe përfitimet nga angazhimet rinore?

Krijimi i respektit

Ndërkohë që fëmijët rriten, ata zhvillojnë një ndjenjë më të rafinuar të vetëdijes dhe një ndërgjegje për të tjerët. Vullnetarët duhet të vendosin mënjane nevojat e tyre për të adresuar nevojat e të tjerëve. Fëmijët që e bëjnë këtë do të mësojnë edhe të vlerësojnë dhe kuptojnë veten e tyre gjatë procesit. Gjithashtu, pjesëmarrja në aktivitete si kujdesi ndaj të moshuarve apo ndihma ndaj të pastrehëve në një moshë të re i prezanton të rinjtë me proceset e përballimit me dilema morale dhe të menduarit për ndryshim shoqëror. Ekspozimi ndaj mundësive kuptimplota vullnetare si fëmijë dhe adoleshent i ndihmon ata të zhvillojnë empati dhe gjithëpërfshirje afatgjatë, cilësi të nevojshme për kultivimin e komuniteteve të sigurta dhe të bashkuara

Aktivizim Rinor që në Idejim të Nismës

Të rinjtë duhet të jenë të pranishëm e të angazhohen që në fazat e hartimit të objektivave të projektit tuaj. Shpeshherë të rinjtë përjashtohen nga fazat e planifikimit për shkak të paragjykit që u bëhet nga të rriturit. Por praktikantët ndërkombëtarë tregojnë se nëse të rinjtë angazhohen herët, ata japin kontribut shumë herë më të madh e janë më aktivë. Nga ana tjetër, edhe të rriturit, përfasqësues të grupeve të ndryshme të interesit marrin një këndvështrim tjetër të situatës dhe krijojnë një lidhje më afektive me të rinjtë. Pjesëmarrja e të rinjve që në fazat e hershme siguron:

- Përfitime të ndërsjella të të rinjve në aftësi, njohuri dhe kapacitete. Ata mund të japin ide të vlefshme dhe të sigurojnë që këto nisma do të pëlqehen edhe nga të rinjtë tjerë.
- Plotësim i programeve të institucionit me ide të reja, energji dhe entuziazëm të cilat sigurojnë zhvillim të ideve sipas nevojave, trendit të kohës dhe koncepteve bashkëkohore;
- Pajisja e institucionit me të dhëna nga vetë ekperiencat e të rinjve të cilat sigurojnë programe e udhëzime më të përshtatshme për ta dhe nga ana tjetër modelesh praktikash pozitive për zbatim;
- Rritje e informacionit të komunitetit mbi vendimet, udhëzimet dhe nismat që institucioni juaj synon të ndërmarrë duke i kthyer këta të rinj në promovues e zedhënës të këtyre mesazheve optimiste;
- Rritje e besueshmërisë së programeve të institucionit tuaj mbi ndërhyrjet dhe aktivitetet advokuese në dobi të komunitetit ku vepron.

Duke përqafuar vullnetarizmin, institucioni juaj fton perspektiva energjike dhe ide të reja. Sipas kërkimeve, të rinjtë janë mjaft të përshtatshëm për të zgjidhur probleme të ndërlikuara shoqërore. Mes moshave 12 dhe 25, kur truri i tyre është i shpejtë dhe i sofistikuar, adoleshentët dhe të rinjtë janë veçanërisht të përshtatshëm për të gjetur perspektiva të reja dhe për të zbuluar zgjidhje kreative.

Zgjerim i Rrjetëzimit Rinor në Vullnetarizëm

Përforcimi i kapitalit shoqëror

Adoleshentët të cilët përfshihen në vullnetarizëm ndërtojnë marrëdhënie dhe fuqizojnë rrjetin e tyre mbështetës, ose ndryshe "kapitalin shoqëror". Kapitali shoqëror fuqizon besimin dhe ndjenjën e komunitetit dhe është kritike për lëvizshmërinë shoqërore. Sipas Opportunity Nation, mundësitë për vullnetarizëm për adoleshentët me të ardhura të ulëta janë veçanërisht të rëndësishme në krijimin e lidhjeve kuptimplota dhe krijimin e rrugëve të edukimit. Kërkimet tregojnë se vullnetarizmi mund të shërbejë si një trampolinë drejt edukimit pozitiv dhe karrierave të mira për të rinjtë me të ardhura të ulëta. Për më tepër, vullnetarizmi është një rrugë efektive për studentët e universitetit në përgatitjet e tyre për të hyrë në tregun e punës; punëdhënësit kanë 82% më shumë mundësi të zgjedhin një kandidat me përvojë vullnetare dhe 85% më shumë mundësi të anashkalojnë mangësitë në CV kur aty ka punë vullnetare

Kjo mënyrë e përfshirjes rinore integron më së miri të mësuarit joformal me qytetarinë aktive në komunitetin ku vepron. Megjithatë është kjo formë është një process zhvillues i cili duhet të kalojë në disa faza:

1

Përfshirja dhe motivimi: Të rinjtë shpesh ndjehen të motivuar të bëhen pjesë e komunitetit, ata kuptojnë përfitimet që marrin nga kjo përfshirje dhe janë edhe kuriozë për personat e tjerë që do të takojnë e për aktivitetet në të cilat do të angazhohen.

2

Socializimi online: Si në çdo komunitet tjetër, edhe në grupimet rinore online anëtarët ndajnë eksperiencat, idetë, besimet, shpresat etj. Duke krijuar kështu vetë një mikro komunitet i cili pasurohet, zgjerohet e zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme duke siguruar edhe qëndrueshmërinë dhe transferimin e johurive.

3

Shkëmbimi i Informacionit: Në momentin që përcaktohen rolet dhe detyrat e gjithësecilit, të rinjtë shkëmbejnë informacion. Ata fitojnë vetëbesim dhe ndërveprojnë me anëtarët e tjerë të komunitetit duke ndërtuar e zhvilluar vazhdimisht njohuritë në mënyrë graduale e të qëndrueshme.

4

Zhvillimi rinor: Njohuritë e përfituara nga grupimet online, të rinjtë arrijnë t'i zërthejnë dhe t'i zhvillojnë në kontekste të caktuara. Mund të nxitin të krijojnë takime online dhe me anëtarë të grupimeve të tjera komunitare dhe të mund të ndërmarrin fushata ndërgjegjësuese për çështje të caktuara.

Mjedis Rinor Miqësor

Çdo institucion duhet të sigurojë aktivizëm rinor me arsye specifike. Edhe kultura e aktivizimit në vullnetarizëm fillon me projekte të thjeshta dhe në momentin më të parë që një institucion ndjen përfitimet e angazhimit rinor, ata aktivizojnë mjete e mënyra se si të sigurojnë qëndrueshmëri në angazhimin rinor kryesisht në planifikime e vendimmarrje.

- Ndërtoni marrëdhënie pozitive me të rinjtë. Analizoni faktin se çfarë mund të përfitojnë të rinjtë nga takimet e drejtpërdrejta me vendimmarrësit.
- Zhvilloni ndjenjën e përkatësisë dhe të sigurisë tek të rinjtë. Bëni analiza dhe veçoni ato cilësi që zhvillojnë tek të rinjtë besimin dhe pozitivitetin.
- Bëjeni pjesëmarrjen rinore në aktivitete vullnetare të argëtueshme dhe sfiduese. Zbuloni nga praktikrat ndërkombëtare se cilat aktivitete të cilësuar si icebrakers apo energizers mund të përdoren për të nxitur të rinjtë.
- Siguroni për të rinjtë informacion të bollshëm mbi çështje të ndryshme dhe vendime të marra nga institucioni juaj. Ekstraktioni ato informacione që ndihmojnë të rinjtë të kenë orientime më të sakta, të mund të zhvillojnë të menduarin kritik si dhe të nxisin pjesëmarrje masive.
- Pajisini të rinjtë me opinione mbi aktivizimin e tyre të deritanishëm si me informacione se si u përdor aktivizimi i tyre dhe çfarë ndryshimi solli.
- Vlerësoni në mënyrë të vazhdueshme aktivizimin rinor, njihni meritat e tyre dhe festoni për këto angazhime.

Bëjeni shoqërore!

Adoleshentët kanë më shumë gjasa të përfshihen në vullnetarizëm nëse edhe shokët dhe shoqet e tyre janë të përfshirë. Inkurajojini ata të ftojnë shoqërinë e tyre dhe të shfrytëzojnë mundësitë. Ju do të arrini më shumë dhe ata do të ndihen entuziastë për kryerjen e aktiviteteve me bashkëmoshatarët e tyre, si një përvojë pozitive e cila i inkurajon ata të vijojnë me aktivitetet vullnetare.

Zhvillimi i Kontakteve të Qëndrueshme

Takimet periodike e të rregullta ndihmojnë në forcimin e grupit të caktuar, sigurojnë organizim e përcaktim detyrash të sakta e të qarta si dhe mundësi për përmirësime në të ardhmen. Gjithashtu, takimet periodike forcojnë edhe marrëdhëniet njerëzore të cilat janë pika kryesore në sigurimin e aktivizimit rinor. Kur angazhohen të rinjtë në një mbledhje planifikimesh e prioritetesh, kini parasysh se po mbështesni transferimin e njohurive nga njëri grup interesi në tjetrin si dhe krijoni një mjedis komunikimi të qartë e të kuptueshëm për të gjithë.

- **Forcohet rrjeti vullnetar:** Përmes ndërveprimit dhe interkativitetit sigurohet qëndrueshmëri e grupit, sukses dhe produktivitet. Nga ana tjetër forcohen edhe ndjesitë njerëzore që lidhen me emocionet, vlerat, zhvillimin e integritetit individual e profesional.
- **Sigurohet Vendimmarrje e duhur:** Gjatë takimeve, vullnetarët mund të diskutojnë mbi situata të ndërlikuara, të japin argumente e të arrijnë në propozime të frytshme për zgjidhje të problemit.
- **Promovohet përfshirja:** Të rinjtë edukohen me ndjenjën e përfshirjes e të kulturës së debatit. Ata e dinë që mund të shprehin lirshëm mendimet e tyre dhe dikush t'i marrë në konsideratë. Këto takime të vazhdueshme krijojnë një mjedis përfshirës e mbështetës për gjithësecilin.
- **Nxitet të menduarit kritik:** Takimet periodike lejojnë të rinjtë të zhvillojnë të menduarit kritik dhe kreativitetin. Një ide e dikujt mund të jetë shumë e bukur, por ajo bëhet e përsosur kur mbështetet edhe nga të tjerët.
- **Mjedis dinamik:** Takimet periodike janë mjedise në zhvillim të vazhdueshëm dhe shërbejnë si kanale për të marrë feedback. Opinione e gjithësecilit jo vetëm japin njohuri, por lejojnë edhe mundësitë për zhvillim e përmirësim.

Një këshillë:

Jepini të rinjve vullnetarë kohën dhe hapësirën e nevojshme të komunikojnë me njëri-tjetrin sepse ata e dëgjojnë më shumë njëri-tjetrin krahasuar me të rriturit.

Transmetimi i Njohurive dhe Prezantimi i Modelit

Shpërndarja e së mirës.

30% e popullsisë së Shqipërisë është nën moshën 24 vjeç dhe 23% nën moshën 19 vjeç. Komunitetet mund ta shfrytëzojnë këtë popullsi me potencial dhe të rrisin programet e përfshirjes vullnetare. Me rjetet e tyre shoqërore të gjera dhe aftësitë teknologjike, të rinjtë mund të jenë rekrutues mjaft të mirë! Inkurajojini të rinjtë të ftojnë miqtë e tyre dhe do të habiteni se sa mund të arrijnë ata së bashku.

Qëllimi i shpërndarjes së njohurive dhe i eksperiencave të fituara nënkupton të kuptuarit sa më mirë të përfitimeve që kanë të rinjtë nga angazhimet në aktivitete vullnetare, por edhe të mirat që vijnë në komunitet nga këto nisma. Sfidat më të mëdha është krijimi i një kulture të qëndrueshme të mënaxhimit dhe të shpërndarjes së njohurive. Disa nga mënyrat se si mund të realizohet ky proces janë:

- Informacion i hapur dhe i transmetuar për të gjithë përmes mediave sociale, pamjeve vizuale, eventeve publike, mesazheve etj.
- Nisma për organizim Info Days që kanë si qëllim pikërisht shpërndarjen e eksperiencave, të historive të suksesit e të praktikave që kanë rezultuar frytdhënëse.
- Ndërmarrja e praktikave trajnuese dhe të ngritjes së kapaciteteve të njësive të transferimit të njohurive me qëllim sigurimin e rjetit zinxhir të vullnetarëve.
- Ngritja dhe zhvillimi i platformave online ku të rinjtë marrin informacion të vazhdueshëm.



Mbështetja e suksesit akademik

Qendrat vullnetare dhe jofitimprurëse kanë nisur të bashkëpunojnë me universitetet për të zhvilluar programe vullnetare. Nga ato, ne kemi mësuar se ndër të gjitha nivelet socio-ekonomike, adoleshentët të përfshirë në vullnetarizëm kanë më pak mundësi të ndihen të ndarë nga shkolla dhe puna. Në fakt, 82% e studentëve që marrin pjesë në programe vullnetare shprehën se kishin ndjenja pozitive në rritje ndaj shkollës së mesme, ndërkohë që 75% e tyre janë dakord se vullnetarizmi i motivon ata të punojnë fort. Këshilli Kombëtar i Lidershipit të të Rinjve thekson se studentët që marrin pjesë në aktivitete vullnetare marrin nota më të larta në studimet sociale, krahasuar me ata që nuk përfshihen në aktivitete të tilla. Kur studentët përfshihen në aktivitete vullnetare, ata tregojnë përfshirje konjitive dhe motivim më të lartë për të mësuar. Arsimtarët kanë nisur të përfshijnë programe vullnetare si një mënyrë për të reduktuar braktisjen e shkollës dhe rritjen e arritjeve akademike ndër të rinjtë në rrezik. Mundësitë për vullnetarizëm së bashku me edukimin e mirë janë “çifti i fuqishëm” i suksesit për të rinjtë e sotëm; shkollat dhe organizatat jofitimprurëse së bashku mund të zhvillojnë programe vullnetare për fëmijët dhe adoleshentët për të mbështetur rritjen e një brezi qytetarësh altruistë

QËNDRUESHMËRIA DHE VIJIMËSIA



Bërja e ndryshimeve të vërteta

Vullnetarizmi u jep të rinjve mundësitë për të punuar me sfidat e vërteta dhe të bëjnë ndryshime të vërteta. Këto përvoja ndryshuese i inkurajojnë adoleshentët dhe fëmijët të përballen me dilema morale, të kërkojnë zgjidhje dhe të përdorin të menduarin inovativ. Ndërkohë që të rinjtë nisin të vënë re ndryshimet e vërteta si rezultat i përpjekjeve të tyre, ata vendosin një lidhje konjitive mes përpjekjes dhe përfundimeve pozitive. Sipas një studimi, të rinjtë që përfshihen rregullisht në vullnetarizëm zhvillojnë një identitet qytetar, si liderë dhe ata që sjellin ndryshimin dhe kështu bëhen të rritur më aktivë në shoqëri dhe politikë.

Nismat, klubet dhe dhe vetë koncepti i vullnetarizmit, kërkon promovim të thellë e të mirëmenduar me qëllim përfshirjen e gjithë aktorëve e grupeve të interesit si dhe mbështetje në nevoja e programe të ndryshme në të mirë të komunitetit. Këto nisma sigurojnë qëndrueshmëri dhe vijimësi kur plotësohen paralelisht në 3 këndvështrime dhe orientime:

- Përgjegjësitë dhe Roli i Vullnetarit;
- Përgjegjësitë dhe Roli i Institucioneve;
- Shkalla e Pjesëmarrjes dhe Suksesi në Angazhimet Vullnetare;

Në fjalën e Opportunity Nation, "Ka një numër të madh provash që tregojnë se vullnetarizmi, përfshirja në projekte shërbimi, dhe forma të tjera të përfshirjes në komunitet janë më tepër sesa aktivitete për t'u ndjerë mirë. Ato kontribuojnë në rezultate më të mira për të rinjtë dhe komunitetet". Me fjalë të tjera, ne të gjithë përfitojmë nëse inkurajojmë sjelljet altruiste të të rinjve në komunitetet tona.

Zhvillimi i aftësive të transferueshme
Të rinjtë praktikojnë rregullisht aftësi në bashkëpunim apo në të zhvilluarit të mendimit kritik në zgjidhjen e problemeve, të cilat janë kyçe në suksesin akademik, në punë dhe në jetën personale. Edhe përmes angazhimit në aktivitete vullnetare të rinjtë zhvillojnë një kuptim të qytetarisë e cila shtrihet në moshën e rritur. Për më tepër, vullnetarizmi ndihmon adoleshentët të mbushin CV-në e tyre me përvojë të fortë në botën e vërtetë. Kjo është arsyeja pse universitetet dhe punëdhënësit shohin aplikantë të përfshirë në botën qytetare të cilët do të shkëlqejnë në grupe dhe në punë sfiduese.

Përgjegjësitë dhe Roli i Vullnetarit

Shumë angazhime vullnetare rrisin motivimin dhe qëllimin për të sjellë një ndryshim. Të rinjtë vullnetarë duhen nxitur e inkurajuar për të ndërtuar një platformë aktivitetesh nën moton RINI AKTIVE e cila nënkupton një program angazhimi të integruar me nisma si vijon:

RINI AKTIVE - NISMA RINORE SOCIALE

përmes angazhimit vullnetar, përgjegjësisë qytetare, ndërgjegjësimit social dhe mundësive për shërbim në komunitet si: ndihmë për të moshuarit, argëtime në kopshte, ndihmë në pastrimin e qytetit.

RINI AKTIVE - NISMA RINORE ARSIMORE

aktiviteteve që sigurojnë zhvillim personal, profesional dhe shoqëror për të rinjtë nëpërmjet trajnimeve, sesioneve informuese të ndryshme, seminareve, konferencave, debateve publike etj, të cilat zhvillojnë aftësinë e udhëheqjes e të lidershipit.

RINI AKTIVE - NISMA RINORE KULTURORE

përmes klubeve rinore ose kurseve me interes të veçantë për vallëzim, interpretim, aktrim, gazetari, pikturë etj.

RINI AKTIVE - NISMA RINORE SPORTIVE

përmes punës ekipore sportive dhe zhvillimin e klubeve sportive për ti dhënë sportit dhe aktivitetit fizik rëndësinë e duhur si në drejtim të shëndetit, ashtu edhe si një element i rëndësishëm në luftën kundër bullizmit e diskriminimit shoqëror.

RINI AKTIVE - NISMA RINORE SIPËRMARRËSE

nëpërmjet inkurajimit të sipërmarrjeve rinore dhe ndërtimin e aftësive teknologjike dhe profesionale përmes aktivitete të tipit Start Up.

RINI AKTIVE - NISMA RINORE VENDIMMARRËSE

përmes pjesëmarrjes së të rinjve në angazhime qytetare dhe si partnerë në vendimmarrje nëpërmjet nismave YOUTH VOTE ku në mënyrë periodike të prezantohen ide, të diskutohen nevojat e komunitetit e të votohet rreth tyre.

Përgjegjësitë dhe Roli i Institucioneve

Zbatimi, përmirësimi dhe vlerësimi i angazhimeve vullnetare kërkon një reflektim dhe nisma të vazhdueshme nga të rriturit si dhe nga institucionet përgjegjëse që japin mundësi për të pasur sukses. Këto nisma duhet të mbështeten në disa element kryesorë si:

Informimit të vazhdueshëm

- o mbi konceptimin, zbatimin dhe gjenerimin e angazhimeve vullnetare.
- o qartësimin mbi përfitimet, vlerat dhe parimet e nismave të marra.
- o arritjet e angazhimeve vullnetare sidomos edhe kur rezultatet tregojnë se inisiativat e ndërmarra kanë sjellë ndryshim.


Krijimin dhe zhvillimin

- o e programeve dhe shërbimeve rinore të arritshme dhe që të reflektojnë tek të rinjtë e komunitetit duke ruajtur përgjegjësinë sociale.
- o e një plani zhvillimor që siguron shërbime për një gamë të gjerë të popullatës e që adreson boshllëqet e identifikuara, duke përfshirë, por jo duke kufizuar, të rinjtë me nevoja të veçanta, popullatat etnike dhe kulturore të ndryshme dhe mbarë komunitetit.
- o e mjeteve të vlerësimit që do të sigurojnë një rishikim të vazhdueshëm të të gjitha shërbimeve, ngjarjeve dhe programeve në mënyrë që të ofrojnë mundësi të kualitetit të lartë për pjesëmarrjen e të rinjve.
- o e mundësive për përfitime të granteve nga qeveria dhe sektori privat për të mbështetur zhvillimin e programeve dhe shërbimeve në fushën e të rinjve.
- o e programeve publike dhe private të drejtuara nga të rinjtë, duke përfshirë ato të ofruara nga organizatat rinore ose organizatat e zhvillimit të të rinjve.

Sigurimit të vazhdueshëm

- o të angazhimit konkret të të tërë personave të përfshirë;
- o feedback-ut kryesisht në drejtim të grupeve të marginalizuara dhe në nevojë;
- o partneriteteve vendore, kombëtare dhe ndërkombëtare për të arritur shkëmbimet e përvojave që synojnë të kontribuojnë në zhvillimin personal dhe profesional të të rinjve të përfshirë;
- o Promovimin e kulturës së komunikimit e të dialogut dhe të mundësive për përmirësim dhe sukses.

Shkalla e Pjesëmarrjes në Vullnetarizëm



© 2005-2017 by Adam Fletcher

Kërkohe një punë e mirëmenduar dhe sistematike që vullnetarizmi të shihet si një angazhim i domosdoshëm dhe i rëndësishëm për zhvillimin demokratik e të qëndrueshëm të një komuniteti, e të ndërtojë një shoqëri me stanarde. Një mënyrë shumë e mirë për të matur shkallën e aktivizimit në vullnetarizëm për të rinjtë dhe jo vetëm, si dhe për të vlerësuar ndikimin që ka ky angazhim tek persona të tjerë të komunitetit është edhe Shkalla e Pjesëmarrjes në Vullnetarizëm (Adam Fletcher). Ky model në fillimet e tij u përdor për të promovuar vullnetarizmin si një element emancipues ku të tre nyjet e tij - Vullnetarët - Komunitetin - Institucionet vendimmarrëse - të mund ta përdorin për të kuptuar se si mund të integrohen, të fuqizohen e të veprojnë me synime të përcaktuara në dobi të shoqërisë në tërësi. Prandaj ky model përfaqëson vizionin e vlerave demokratike dhe pjesëmarrje të orientuar për tërë anëtarët e një komunitetit. Shkalla nuk është statike por ndihmon institucionet, komunitetin dhe individët të identifikojnë vetvetën se në cilin pozicion të saj gjenden.

8

Partneritet i Drejtë - propozimet vijnë nga vetë komuniteti dhe organet e vendimmarrjes japin kontribut në zbatimin e këtyre propozimeve. Në këtë rast vullnetarët ndjehen të motivuar dhe shërbejnë si modele inkurajuese edhe për anëtarët e tjerë të komunitetit.

7

Partneritet i Vetëdrejtuar - kur komuniteti ndërmerr propozime apo nisma dhe vullnetarët e eksperiencë kanë rol të rëndësishëm mbështetës.

6

Partneritet i Barabartë - kur edhe vetë komuniteti, edhe organet vendimmarrëse ndërmarrin nisma dhe japin kontribut në mënyrë të barabartë me qëllim arritjen e ndryshimit dhe të përmirësimit të situatës;

5

Konsultimi - kur komuniteti jep mendime, udhëzime, ndan eksperiencë personale të cilat zbatohen më tej nga vetë vullnetarët në mënyrë të pavarur.

4

Përfshirja - kur nismat paramendohen nga persona të tjerë jashtë komunitetit dhe anëtarët e tij angazhohen në role e përgjegjësi të ndryshme për përmbushjen e tyre.

3

Tokenizëm - kur ndërmerren nisma nga anëtarët e komuniteti për të dhënë ide e mendime, por që në fakt ato nuk gjejnë shumë hapësira për të vijuar më tej. Pra, nisma në nivel sipërfaqësor.

2

Dekorimi - kur anëtarët e komunitetit ftohet e angazhohen në mënyrë jo të drejtpërdrejtë për një çështje të caktuar dhe vetë vullnetarët e promovojnë këtë si nismë personale dhe jo që buron nga komuniteti.

1

Manipulimi - ndodh kur vullnetarët thjesht përdorin anëtarët e komunitetit dhe pretendojnë që kauzat janë frymëzuar nga vetë komuniteti.

MBËSHTESNI YOUTH ACTING!

48 orë maratonë vullnetare:

- Aktivitete sportive gjithëpërfshirëse;
- Vizitë në shtëpinë e të moshuarve;
- Vizitë në spitalin pediatrik;
- Panair ndërgjegjësues mbi vullnetarizmin;



Grupet e interesit

Qeveritë vendore, shoqëria civile dhe institucionet arsimore luajnë një rol kritik në formësimin dhe zhvillimin e jetës shoqërore dhe ekonomike të territoreve të tyre, duke i sjellë komunitetet më pranë njëri-tjetrit dhe duke ofruar mjedise e kushte të përshtatshme për zgjidhje të problemit e për ndërtimin e një shoqërie të shëndetshme.

Kultura e përfshirjes në aktivitete vullnetare po zhvillohet gjithmonë e më shumë e si rrjedhojë shfaqen problematika në angazhimin e institucioneve përgjegjëse në rritjen e numrit të rinjve në vullnetarizëm e në angazhimin e tyre në aktivitete vullnetare.

Vullnetarizmi në institucionet vendore e qendrore

Institucionet e qeverisjes vendore perceptohen se kanë një ndërgjegjësim të dobët në njohjen e kulturës së vullnetarizmit. Ky ndërgjegjësim është akoma më i dobët te institucionet në zona të largëta rurale. Këto institucione nuk kanë një plan afatgjatë të organizimit të vullnetarëve sipas një agjende të përcaktuar. Organizimi i tyre bëhet shpeshherë ad hoc, sipas nevojave që paraqet bashkia apo komuniteti në periudha të caktuara. Mungesa e një strukture të qëndrueshme bëhet pengesë për një organizim të planifikuar dhe afatgjatë të vullnetarëve. Bashkitë nuk kanë një strukturë të dedikuar për vullnetarizmin, por praktikat vullnetare realizohen në kuadër të ndonjë iniciative apo projekti. Rrjeti i vullnetarëve në bashki menaxhohet në disa raste nga Drejtoria e Rinisë, por nuk është një praktikë e institucionalizuar sipas ligjit të vullnetarizmit.

Një strukturë e rëndësishme që mund të lehtësonte procesin e koordinimit dhe menaxhimit të vullnetarëve është Këshilli Rinor Vendor, si një strukturë e krijuar rishtazi. Në bazë të Ligjit të Rinisë, bashkitë janë të detyruara të krijojnë Këshillat Rinore Vendorë dhe në këtë rast edhe vullnetarizmi diskutohet në agjendën e Këshillit. Megjithatë, efektshmëria e këtyre strukturave ngelet për t'u konsoliduar më tej.

Nga ana tjetër, Drejtoritë e Mirëqenies Sociale apo këndet e BE-së kanë qenë disa nga alternativat e diskutuara më së shumti gjatë fokus grupeve me përfaqësues të bashkive. Vetë organet e qeverisjes vendore kanë tendence pozitive për të nxitur vullnetarizmin dhe pranimin e hapur se vullnetarizmi është një forcë shumë e madhe zhvilluese, por që këto institucione kanë nevojë për më shumë kapacitete, mirëorganizim dhe fokus. Fakti që janë të hapur dhe të gatshëm është një indikator shumë i rëndësishëm për të ndërmarrë hapa konkretë si:

- Ndërmarrja e nismave konkrete, strategjive apo planeve të veprimit.

- Ngritja e grupeve të punës me përfaqësues të institucioneve qendrore dhe aktorëve të tjerë përgjegjës për zhvillimin e vullnetarizmit;

- Ngritja e një netëork-u ndërmjet institucioneve të ndryshme si: Ministria e Financave, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, Shërbimi Kombëtar i Punësimit, bashkitë, organizata, shkolla dhe universitete, media etj

Vullnetarizmi në organizatat e shoqërisë civile

Studimet tregojnë se organizatat e shoqërisë civile janë hapësira ku vullnetarët dinë ku të orientohen në rast se duan të kontribuojnë vullnetarisht. Institucionet vendore dhe ato të arsimit shohin gjithashtu OSHC-të si potenciali më i mirë që mund të ofrojnë mundësi vullnetarizmi për qytetarët në kushtet ku jemi. Mënyrat e angazhimit të vullnetarëve nga OSHC-të janë nga më të ndryshmet.

Mënyra më efikase është së pari, vlerësimi i nevojave të vullnetarëve dhe si kjo nevojë mund t'u shërbejë edhe interesave të organizatës ose tregut. Një praktikë e konsideruar pozitive dhe e ndjekur nga një OSHC-të ka qenë rekrutimi i vullnetarëve përmes të ofruarit të praktikave të punës dhe krijimit të mundësive për vullnetarizëm apo punësimin e personave që tregojnë një angazhim më serioz.

Një tjetër praktikë e përdorur për rekrutimin e vullnetarëve nga një pjesë e konsiderueshme e pjesëmarrësve në fokus grupe është edhe lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet arsimore, me qëllim realizimin e praktikave mësimore në organizata. Ndonëse praktika mësimore nuk lidhet drejtpërsëdrejti me aktivitetin vullnetar, pjesëmarrësit i konsiderojnë shpeshherë pjesë e punës vullnetare:

Praktika të ngjashme zbatohen dhe nga organizata të ciat kanë eksperiencë me vullnetarët evropianë dhe ndërkombëtarë. Praktika të tilla janë thelbësore të ndiqen nga sektori, janë praktika që garantojnë koordinim dhe qëndrueshmëri të impaktit të vullnetarizmit si në nivel shoqëror por dhe në atë individual, duke mos neglizhuar ndikimin pozitiv që japin në organizatë.

Një element mjaft i rëndësishëm në menaxhimin dhe cilësinë e praktikimit të vullnetarizmit, është trajnimi apo rritja e kapaciteve të vetë organizatave. Në përgjithësi ekziston ideja që çdokush mund të merret me vullnetarët, mund të koordinojë dhe mund të motivojë. Megjithatë një trajnues pa përvojë mund të bëhet ndonjëherë shkak për mos vijimin e eksperiencës së vullnetarizmit.

Vullnetarizmi në institucionet arsimore

Gjatë realizimit të fokus grupeve në institucionet arsimore janë evidentuar një sërë praktikash të mira të vullnetarizmit. Në disa raste vullnetarizmi ngatërrohet me orët komunitare si nga ana e mësuesve, ashtu dhe nxënësve, por në këtë rast janë sjellë praktika të mirëfillta të vullnetarizmit. Në institucione të ndryshme organizohen më shumë veprimtari humanitare sesa vullnetare, por janë vetë nxënësit që shfaqin interes për të shërbyer si vullnetarë në ndihmë të komunitetit. Shpeshherë nxënësit marrin iniciativa vullnetare, që nga dhuratat qoftë në të mira materiale simbolike modeste, por që e kanë marrë përsipër dhe e kanë parë që është një gjë interesante, e këndshme dhe bashkëpunuese. Të gjitha këto, si të thuash, na çojnë në këtë hullinë e madhe, ku njeriu ndjehet solidar, altruist, bashkëpunues.

Në fakt, vullnetarizmi është i kultivuar dhe në rritje e sipër, duke qenë se situatat e ndryshme që kanë ndodhur në Shqipëri, i kanë bërë nxënësit të jenë pak më të ndjeshëm për sa i përket kësaj teme. Një mësues duhet ta nxisë këtë frymë, duke nxitur vullnetarizmin social, d.m.th., një nxënës i dobët të merret përsipër për ta ndihmuar nga një nxënës i mirë, duke e mbajtur në bankë apo duke e ndihmuar për detyrat. Ose duke parë nxënësit që bullizohen, të nxisin masën që t'i mbështesim dhe mos t'i lënë personat agresivë, por t'i vënë në qendër të vëmendjes.

Edhe pse në realitetin e Shqipërisë vullnetarizmi është shtyllë e shoqërisë civile, institucionet e arsimit, të të gjitha niveleve, nëpërmjet praktikave pozitive mund të inkurajojnë shumë vullnetarë, komuniteti, ashtu dhe të rinjtë. Është e rëndësishme që këto institucione të zhvillojnë dhe promovojnë sa më shumë këto praktika, të nxisin dhe të motivojnë këdo, të jenë të hapura dhe bashkëpunuese me qytetarët dhe institucionet. Të qenit të hapur ndaj praktikave të mira dhe të reja do të shkonte në përputhje shumë të ngushtë me nevojat e institucionit dhe interesave të qytetarëve. Informimi, motivimi dhe rritja e kapacitete të mësuesve janë kyçi për të pasur shkollat si palë dhe të kenë rol proaktivë në nxitjen dhe ushtrimin e vullnetarizmit. Përqasja pozitive institucionale dhe të qenit mendjehapur dhe bashkëpunues janë të një rëndësie thelbësore

Të rinjtë jetojnë e ndërveprojnë në një mjedis shoqëror kompleks e dinamik duke përfshirë shkollën, aktivitetet ekstrakurrikulare, grupet shoqërore, familjet, organizatat e shoqërisë civile etj. Zhvillimi i potencialeve rinore dhe përfshirja e tyre e vazhdueshme në aktivitete të shëndetshme, realizohet më së miri kur të tërë keta element ndërthuren dhe për më tepër sigurojnë bazat e një shoqërie me norma të larta në një periudhë afatgjatë.


Një koncept që çdo institucion duhet ta mbështesë e zhvillojë më tej duke krijuar sinergji e ndërlidhje mes një të riu dhe mjedisit rrethues duke zhvilluar tëk ata ndjenjën e përkatësisë komunitare.

Nxitja e përfshirjes përgjatë jetës - Ju jo vetëm që do të keni një numër të madh vullnetarësh në terma afatshkurtër, por edhe do të mund të ndërtoni marrëdhënie afatgjata. Kjo sepse ata që përfshihen në vullnetarizëm kanë më shumë mundësi të jenë bamirës ndaj komuniteteve të tyre. Përpiquni të arrini tek prindërit e tyre për të zhvilluar programe të rregullta specifike për vullnetarizmin e të rinjve; të rinjtë e sotëm mund të jenë mbështetësit tuaj për vite me radhë! Pjesëmarrja në mundësi vullnetare dhe qytetare në një moshë të re zhvillon empatinë, frymëzon ndjesinë e qytetarisë dhe ndihmon në gjetjen e rrugëve për edukim dhe punë kuptimplotë. Në fakt, të rinjtë vullnetarë ndihmojnë në përmirësimin e së tashmes, duke siguruar edhe të ardhme të sigurt dhe të shëndetshme për veten dhe komunitetin.

Mendoni për të ardhmen - Rikujtoni adoleshentët se arritjet në vullnetarizëm mund t'i ndihmojnë ata të përgatiten për shkollën e lartë dhe në forcën e punës në të ardhmen. Të rinjtë pa përvojë pune por me përvojë vullnetare kanë më shumë gjasa të punësohen krahasuar me të rinjtë pa përvojë pune, edhe nëse ata dalin me rezultate të mira akademike. Vullnetarizmi i ndihmon ata të përftojnë një sens të vërtetë të ndryshimit që po bëjnë.

Në fund të ditës vullnetarizmi është një ndijim personal. Është një dëshirë për t'u ndjerë i përfshirë në komunitet. Për t'u ndjerë i përfshirë në akte humane që ngrenë lart shpirtin e njeriut. Na mëson se sa e vlefshme është jeta në bashkësi.

Vullnetar – Youth Act



Frymëzoni pak konkurim të shëndetshëm - Adoleshentët përgjigjen mirë ndaj konkurimit. Ata gjithashtu kanë dëshirë të fitojnë diçka në përfundim të një detyre, si për shembull një ertifikatë mirënjohjeje apo edhe një letër nga kryetari i Bashkisë si metoda efektive për t'i inkurajuar ata. Është shumë e rëndësishme që të rinjtë të kenë orë të caktuara për aktivitete vullnetare dhe qëllime konkrete për të cilat ata duhet të punojnë, të marrin pjesë në aktivitete të veçanta, si dhe të ndihen pjesë e një ekipi.

Integroni me botën akademike - Shkollat gjithnjë e më shumë po shohin të integrojnë aktivitetet vullnetare në kurikulat e tyre. Punoni me shkollat në zonën tuaj për të zhvilluar programe vullnetare të rregullta dhe mbështetje për edukimin përtej mureve të shkollës. Punoni me mësuesit për të integruar punën në klasë me botën jashtë. Lejoni studentët të identifikojnë çështje me rëndësi për ta, zhvilloni një plan veprimi dhe kryeni punën. Siguroni mundësitë për reflektim me gojë ose me shkrim pas çdo seance për të ndihmuar mbajtjen e njohurive. Studentët kanë më shumë gjasa të angazhohen më tepër kur ata perceptojnë se ju jeni vetë të angazhuar nga fillimi deri në fund. Ndërkohë, ata ushtrohen me zakone të rëndësishme si zgjidhja e problemeve dhe puna në grup.

Puna vullnetare ndihmon në nxitjen e besimit më të madh mes qytetarëve dhe zhvillimin e normave të solidaritetit dhe reciprocitetit të cilat janë thelbësore për një komunitet të qëndrueshëm.

Vullnetar – Youth Act

Referenca

Katrin Alban, 2012, SALTO-YOUTH Inclusion Resource Centre

<https://www.salto-youth.net/rc/inclusion/inclusionpublications/youthandthecity/>

Danijela Matorčević, Aleksandra Gligorović, 2017, South East European Youth Network – SEEYN Secretariat Skenderpašina 1

https://www.salto-youth.net/downloads/toolbox_tool_download-file-1612/SEEYN%20VOLUNTEER%20MANAGEMENT%20HANDBOOK.pdf

Finn Yrjar Denstad, 2009, Council of Europe Publishing

https://pjp-eu.coe.int/documents/42128013/47261809/YP_Manual_pub.pdf/b17e1e6-e8b6-4041-902e-3b3ad0973c45

Oltiana Rama, Armela Xhaho, 2021

https://pvnalbania.org/wp-content/uploads/2021/06/Vullnetarizmi-ne-Shqip-eri_-Studimi-Kombetar-1.pdf

Addisson Waters, 2022, Galaxy Digital

<https://www.galaxydigital.com/blog/youth-volunteerism#:~:text=Volunteering%20gives%20youth%20the%20opportunity,solutions%2C%20and%20employ%20innovative%20thinking.>

Addisson Waters, 2022, Galaxy Digital

<https://www.galaxydigital.com/blog/engage-teen-volunteers>

Adam F.C. Fletcher, 2017

<https://adamfletcher.net/2017/08/29/purpose-empowerment-and-the-experience-of-volunteerism-in-community/>

Pan-Canadian Joint Consortium for School Health, Youth Engagement Toolkit

http://www.gov.pe.ca/photos/original/eecd_YETOOL_E.pdf

<https://kanbanzone.com/2020/why-effective-team-meetings-are-important/>

<https://participationpool.eu/toolkit/>

<https://www.trvst.world/charity-civil-society/volunteering-facts-statistics/>

Ky publikim është prodhuar në kuadër të projektit
"YOUth ACTING"
i cili realizohet me mbështetjen financiare të LevizAlbania dhe është një projekt i
Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, SDC
Mendimet dhe opinionet e shprehura në të i përkasin autorëve realizues dhe
nuk përkojnë domosdoshmërisht me qëndrimet e donatorit.

info@youthact.al
www.youthact.al
Rruga e Kosovarëve, nd. 41
Tirana -Albania

Copyright © Qendra YouthAct

Financuar nga:



Një projekt i Agjencisë Zvicerane SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC